

FJALA E DEPUTETES ERISA XHIXHO

E ENJTE 21 KORRIK 2022

E nderuar Kryetare e Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë!

Problemet që janë objekt i projektligjit “Për regjistrin kombëtar të të dënuarve për krime seksuale”, mbeten ndër më të shfaqurat mesh nesh dhe evidentohen herë pas here, të gjithë shqetësohemi kur mësojmë për akte dhune dhe abuzimi nga pedofilët, e jo vetëm ndaj fëmijëve të mitur; kur mësojmë për pandëshkueshmërinë e madje edhe për përkujdesjen ndaj tyre, që jo rrallë i punësojnë për vota që vjedhin e japin, apo për militantizmin si veprimtarë partie. Paradoksisht, ky Kuvend jo vetëm nuk ka denjuar të merret me këto probleme dhe me këto çështje me impakt social, psikologjik e publik, po përkundrazi, për nëntë vjet ka bërë sehir dhe është tallur me veten, në radhë të parë, është tallur me besimin e qytetarëve e me pritshmëritë e tyre, duke e mbajtur këtë projektligj nëpër sirtarët e mykur të indiferencës së vet.

Thënë ndryshe, nëse do të ishte miratuar me kohë, shumë prej abuzimeve do të ishin parandaluar, shumë fëmijë do të ishin mbrojtur dhe shumë prej kriminelëve, që sot livadhisin kudo, nuk do të ishin emëruar mësues dhe nuk do të ishin bërë drejtorë për merita të veçanta. Ne si LSI, e kemi mbështetur me forcë këtë nismë, edhe unë personalisht. Do të vazhdojmë të mbështesim çdo nismë, e cila ka si qëllim zgjidhjen e problemeve shumë të mëdha, që kanë fëmijët, gratë dhe vajzat në Shqipëri. Ky ligj i ri është një mekanizëm parandalues, i nevojshëm për t’i bërë më të sigurtat mjediset ku rriten fëmijët tanë, për të theksuar domosdoshmërinë e këtij mekanizmi. Më lejoni t’ju kujtoj disa shifra: vetëm brenda afatit 1 janar 2019 – 1 qershor 2020, 66 fëmijë kanë rënë pre e ngacmimit dhe e dhunës seksuale nga ana e personave të afërt apo janë dhunuar seksualisht nga familjarët e tyre.

Prej tyre, tri vajza janë vetëvrarë. Një fëmijë që bëhet viktimë e abuzimit seksual, shënjohet përjetë. Përtej pasojave fizike, janë edhe ato psikologjike, që e shoqërojnë deri në fund të jetës. Trauma e abuzimit është një plagë që nuk mbyllet kurrë plotësisht. Madje, më vonë mund të

ndodhë që vetë i abuzuari të kthehet në abuzues. Abuzimi seksual gjeneron dhimbje, frustrim, humbje të vetëvlerësimit, humbje të besimit tek njerëzit, depresion dhe në disa raste vetëvrasjeje. Fatkeqësisht, këtij fenomeni nuk mund t'i japim fund njëherë e përgjithmonë me anë të këtij ligji, por duhet thënë se me këtë ligj kemi sot në dorë një mjet të fortë parandalues dhe të parandalosh, padyshim, është gjithmonë më mirë sesa të kurosh.

Në hartimin e këtij projektligji janë marrë për bazë eksperiencat më të mira të vendeve të Bashkimit Europian, si e Britanisë, Irlandës, Francës, madje edhe e Maqedonisë së Veriut. Projektligji ka për qëllim inkurajimin dhe përgatitjen e organeve kompetente shtetërore për të mbrojtur fëmijët, të rinjtë, gratë dhe çdo individ nga dhuna dhe shfrytëzimi seksual, duke siguruar që regjistri të jetë mjet efektiv për të identifikuar vendndodhjen e të dënuarve për krime seksuale dhe për monitorimin e aktivitetit të tyre. Regjistri u mundëson Policisë së Shtetit dhe organeve të tjera ligjzbatuese t'i identifikojnë dhe monitorojnë këta grabitqarë seksualë e pedofilë ndaj të cilëve ka një vendim të formës së prerë nga gjykata, duke disponuar informacionin e detajuar lidhur me të dhënat personale, vendbanimin, rrethin shoqëror e të tjera.

Regjistri, gjithashtu, garanton ndalimin e personave të dënuar për krime seksuale për t'u punësuar/angazhuar si pjesë e personelit të institucioneve, agjencive, organizatave dhe çdo subjekti shtetëror dhe joshtetëror që punon për fëmijët apo persona të tjerë të rrezikuar ose të pambrojtur në Republikën e Shqipërisë. Më lejoni t'ju kujtoj këtu rastin e Beratit, ku një mësues arriti të përfshihej në sistemin tonë arsimor, sepse ky regjistër dhe ky ndalim që ne sot miratojmë nuk ekzistonin, apo edhe rastin e prillit 2022, ku një drejtor në Lushnjë ngacmoi seksualisht një vajzë 15-vjeçare. Me anën e këtij projektligji do të ndalohen përfundimisht punësimi i këtyre grabitqarëve seksualë. Aksesi ka qenë, gjithashtu, një debat për regjistrin nëse do të ishte i kufizuar ose jo.

Ky regjistër, të dashur qytetarë, do të jetë i hapur të adresohet dhe të aksesohet nga njësitë për mbrojtjen e fëmijëve në çdo bashki, nga zyrat arsimore vendore, nga të gjitha institucionet e drejtësisë, nga Departamenti i Administratës Publike, si dhe nga çdo qytetar apo prind që ka një shqetësim, padyshim duke u identifikuar vetë për çdo të dhënë që kërkon. Që në krye të herës

jam angazhuar maksimalisht, bashkë me shoqërinë civile, për të garantuar një ligj i cili të jetë mundësisht i zbatueshëm, të japë rezultate konkrete për rritjen e sigurisë për fëmijët, për personat vulnerabël, një ligj i cili i bën më të sigurt komunitetet ku ne jetojmë. Padyshim, miratimi i këtij ligji nuk është finalizimi i misionit tim si nismëtare.

Duke e votuar sot, ne vetëm sa shtrojmë terrenin ligjor për të bërë më shumë në luftën kundër abuzimit seksual. Monitorimi i zbatimit të këtij ligji është hapi i dytë, ndoshta edhe më i rëndësishëm. Unë personalisht garantoj se do të ushroj të gjithë kontrollin tim parlamentar me të gjitha mekanizmat ligjore, do të përdor çdo gjë në zbatimin sa më eficient të këtij ligji. Padyshim, dua të falënderoj ekspertët e shoqërisë civile, Qendrën e Fëmijëve, CRCA-në, 22 mijë zgjedhës që, gjithashtu, sollën një material në Kuvendin e Shqipërisë, kolegët e mi deputetë të Komisionit të Ligjeve, të Komisionit të Shëndetësisë, të Komisionit të Sigurisë, të cilët përtej debateve arritëm ta kalonim me një konsensus të gjerë këtë projektligj!

Në fund, më lejoni të shpreh qëndrimin tim, pse jo, që ky projektligj të jetë një leksion për këtë Kuvend, për klasën politike shqiptare, ku interesi publik, shqetësimet e qytetarëve, të cilat janë prezente sot, do të duhet, si këtë nismë, ta shqyrtojmë menjëherë pa humbur kohë në Kuvend, pasi mendoj se përtej opozitës dhe maxhorancës do të duhet të jetë interesi i qytetarëve. Faleminderit!